



In medias res

Formulimi i Vizionit

“Shpërblimi i Zotit për mua është potencial im. Shpërblimi im kthyes për Zotin është ajo çka unë bëj me potencialit tim?”

Meqë jemi duke folur për vizionin, ne do të trajtojmë shumë shkurt problemin e formulimit të vizionit nga shkencëtarët dhe shtetet nga kontinentet e ndryshme. Në këtë pjesë të trajtimit të vizionit do ngrihemi në një nivel më të lartë në nivelin e shtetit sepse në shtetet e zhvilluara janë formuluar vizione gjatë çdo periudhe të historisë bashkëkohore. Këto vizione janë zhvilluar nga komisione kombëtare e grupe të posaçme pune në kuadrin e shqetësimeve dhe të problemeve kryesore të një shoqërie në ndryshim (Orstein & Hunkins 397).

Një ndër të parët që bëri përpjekje për të definuar vizionin e shoqërisë ishte H. Spensper. Ky në bazën e analizës së kohës së tij erdhi në përfundim që: “...individët të bëjnë jetë të suksesshme, ata duhet të përgatiten për pesë sfera veprimtarish: (1) vetë – ruajtja e drejtpërdrejtë, (2) vetë – ruajtja e tërthorët (sigurimi i ushqimit, i strehimit dhe të ardhurave për jetesë), (3) rritja e fëmijëve, (4) qytetaria dhe (5) veprimtaria në kohën e lirë...”

Në SHBA, në vitin 1918, pas përfundimit të Luftës së Parë, Komisioni për Riorganizimin e arsimit të mesëm, nxori raportin me titull: Parimet themelore të arsimit të mesëm. Në këtë raport vizioni definohet: “Si brenda shkollës ashtu edhe jashtë shkollës; arsimi në demokraci duhet të zhvillojë te çdo individë njohuritë, interesat, idetë, zakonet dhe kompetencat, me anën e të cilave ai do të gjejë vendin e tij dhe do ta përdorë këtë vend për ta formuar veten dhe shoqërinë drejtë qëllimeve gjithnjë e më fisnike” (Orastein & Hunkins, 397). Vizionet në arsim u rishikuan në SHBA në vitet 1938, 1944, 1961, 1983.

Në Francë vizioni fillon të definohen më qartë në vitin 1923. Kështu: Vizioni i arsimit përcaktohet kështu: “të pajisë punëtorët me dije, të rrisë rendimentin e aktivitetit prodhues, të marrë nga fuqia e krahëve maksimumin që do të dhjetëfishojë fuqinë dhe begatinë e Francës, duke i dhënë racës franceze ripërtëritjen e forcave dhe të energjive” Udhëzimet zyrtare theksojnë se: “...objekt i arsimit të detyruar nuk është përvetësimi i të gjitha njohurive të mundshme në të gjitha lëndët, por përvetësimi i atyre njohurive që nuk mund të injorohen”

Në kontinentin e Afrikës vizioni i arsimit definohet: “Edukimi është mjet për të realizuar një projekt për zhvillimin e shoqërisë. Ai duhet të jetë mjet për ta realizuar këtë zhvillim ku vendin sundues do ta ketë drejtësia, demokracia, liria, mundësia për t’u begatuar si në nivelin kolektiv ashtu edhe individual”

Në Amerikën Latine “vizioni i edukimit definohet si mjet çlirimi nëpërmjet identifikimit dhe të denoncimit të faktorëve jo human që veprojnë në marrëdhëniet socio ekonomike, politike dhe kulturore”

Në Azi me gjithë specifikat e shteteve dhe të vendeve ekziston një vizion që vlen për të gjitha shtetet dhe vendet. Ky është: Krijimi i identitetit kombëtarë dhe themelimi kombëtarë”.

Në vitin 1957, në shtetet arabe vizioni i arsimit definohet: “ finaliteti (vizioni) i edukimit është të formojë një brez arabësh të ndriçuar që besojnë në Zotin dhe kombin. Ata, që kanë besim në vetvete dhe në popullin e tyre, në sjelljen individuale dhe shoqërore, që frymëzohen me ideale të larta morale, që i nënshtrohen parimeve të së drejtës dhe të mirës, që kanë vullnetin për të punuar për çështjen e përbashkët, që kanë aftësi të punojnë në mënyrë konstruktive, të armatosur me dije dhe me forcë morale, të jenë gatshëm mbrojnë vendin që zë populli arab në këtë botë dhe të sigurojë të drejtën e çdo arabi për të jetuar i lirë, i sigurt dhe në dinjitetet”

Emanuel Kant vizionin e edukimit e deklaroi me fjalët: “Edukata ka për funksion të realizojë thelbin e njeriu”

Meqë tani i kemi të qarta disa formulime të vizioneve në fushën e edukimit, në vazhdim do të flasim për formulimin e vizionit kurrikular, burimet e vizioneve dhe për kriteret e për përcaktimit të vizionit

Shkroi: Halim Hyseni

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit prill ka filluar rundi i dytë i përzgjedhjes së shkollave përfituese në kuadër të projektit të granteve për zhvillimin e shkollave. Meqenëse në rundin e parë janë përzgjedhur 114 shkolla përfituese nga 151 sa ishin parapara me marrëveshjen në mes të MASHT dhe KEC, në rundin e dytë mbeti të përzgjidhen 37 shkolla. Këtij numri të shkollave iu shtuan edhe 20 shkolla të tjera, si ofertë e KEC për shtimin e numrin të shkollave në rast të përballimit financiar nga ana e projektit. Përzgjedhja e 57 shkollave përfituese është bërë nga ana e Ekipeve Komunale për Grante Shkollore. Lista e shkollave të përzgjedhura është dorëzuar tek përfaqësuesit e ekipit koordinues të projektit në MASHT, i cili më datën 22 prill organizoi takimin e Këshillit për Aprovimin e Granteve të Shkollave (KAGSH). KAGSH ka aprovuar listën e 57 shkollave përfituese të rundit të dytë. Pas takimit të KAGSH, bashkëpunëtorët profesional të terrenit kanë kontaktuar drejtorët e shkollave përfituese dhe i kanë ftuar nga dy përfaqësues të shkollave përfituese për të marrë pjesë në trajnimin për hartimin e planit zhvillimor të shkollës. Më 27 dhe 28 prill janë mbajtur trajnimet për PZHSH në 5 qendra të Kosovës: në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj dhe Mitrovicë. Të gjithë përfaqësuesit e shkollave përfituese kanë marrë pjesë në trajnim. Për përfaqësuesit e shkollave serbe të Graçanicës dhe të Shtërpcës trajnimi për PZHSH do të mbahet më 10-11 maj 2011.

■ Ndërsa shkollat e rundit të parë janë në proces të kompletimit të dokumenteve dhe procedurave të nevojshme për prokurim.

KOSOVISION Contest

■ Gjatë këtij muaji vazhduan aktivitetet nëpër klasat fituese. Nxënësit dhe mësuesit e tyre me një dëshirë të madhe punojnë për ti realizuar objektivat e projektit. Gjatë këtij muaji, vizita të shumta janë bërë në të gjitha klasat fituese nga menaxhuesit e projektit. Projektet janë të ndryshme. Secila klasë mundohet që projekti i tyre të jetë më i miri. Disa nga shkollat edhe kanë përfunduar fazën e dytë të projektit. Gjatë këtij muaji rreth 10 klasa kanë bërë edhe hapjet solemne për projektin. Të gjithë nxënësit dhe mësuesit janë duke punuar edhe në dokumentimin e projektit. Vlerësimet e projektit do të bëhen në fund të muajit maj.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

- Monitorimi i katërt ka përfunduar. Të gjitha të dhënat janë dorëzuar në KEC dhe tani do të fillohet të punohet edhe në raportin e dytë të monitorimit i cili më pas do të përkthehet në gjuhë tjera dhe do të prezantohet në publik për të parë dallimin në mes të raportit të parë dhe të dytë dhe për të parë ndikimin e projektit në shkollat tona.

- Grantet shkollore të cilat u janë dhënë shkollave. Deri në fund të muajit prill, ata kanë realizuar projektet në shkollat e tyre dhe gjatë muajit maj ata sjellin raportet për projektet e zhvilluara.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Më 8-10 prill 2011 u mbajt konferenca përfundimtare “Fuqizimi i palëve me interes në arsim” në kuadër të projektit “Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim”. Kjo konferencë u mbajt në Durrës, Shqipëri ku morën pjesë rreth 70 pjesëmarrës nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova dhe Serbia. Në mesin e pjesëmarrësve kishte përfaqësues të ministrive të arsimit, drejtorë shkollash, mësimdhënës, prindër, përfaqësues të grupeve pakicë, etj. Gjatë konferencës u prezantuan rezultatet e projektit, hulumtimet kombëtare dhe sinteza e tyre, praktikat e mira dhe iniciativat lokale. Iniciativat lokale u prezantuan nga përfaqësuesit e shkollave të cilët i kanë zbatuar projektet në shkollë. I gjithë prezantimi i praktikave të mira, gjendjes së arsimit dhe përfaqësimit e pjesëmarrjes së prindërve, me theks të veçantë te prindërit e grupeve pakicë, dhe prezantimi i iniciativave lokale u pa me shumë interes nga të pranishmit në konferencë. Pjesëmarrësit u ndanë shumë të kënaqur me konferencën, e në veçanti me mundësinë që u dha për t’i shkëmbyer mes vete përvojat, brengat dhe idetë, qoftë gjatë konferencës apo edhe gjatë kohës së lirë.

■ Më 11-12 prill 2011 në Bruksel u mbajt Konferenca Finale e organizuar nga Programi i Komisionit Evropian “Përkrahje Dialogut të Shoqërisë Civile – Veprimet Njerëzit për Njerëzit”. Në këtë konferencë morën pjesë nga 4 përfaqësues prej 8 projekteve rajonale të financuara nga Komisioni Evropian. Të gjitha projektet i prezantuan rezultatet e tyre si dhe u diskutua për sukseset dhe sfidat që janë paraqitur gjatë implementimit të projekteve. Projektin

APREME e përfaqësuan Ivona Celebicië nga proMENTE – Bosnje dhe Hercegovinë, Asja Korbar nga NEPC – Kroaci, Shkelzen Gashi dhe Jehona Xhaferi nga KEC – Kosovë.

Hap pas Hapi

■ Me 5,6,7 prill në KEC u mbajt trajnimi treditor Hap pas Hapi për klasën e tretë. Prezantimi i planifikimeve nga ky grup do të bëhet gjatë muajit maj.

■ Gjatë këtij muaji kanë vazhduar monitorimet nëpër klasat që zbatojnë metodologjinë HpH.

Parandalimi i dhunës në shkolla

■ Gjatë muajit prill për zbatim të suksesshëm të projektit është përgatitur një Paketë e udhëzimeve si dhe është mbajtur punëtorja dy ditore në Prizren me kryetarë dhe anëtarë të Komiteteve komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

■ Gjatë këtij muaji është përgatitur edhe drafti i Protokollit Special për Parandalimin e të gjitha llojeve të Dhunës në institucionet shkollore. Ky draft në institucionet shkollore do të jete në diskutim publik deri e 20 maj 2011.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Me 19-20 prill 2011 në Prishtinë u organizua punëtorina “Zhvillimi i materialeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies për nxënës dhe mësimdhënës”. Pjesëmarrësit ishin Mësimdhënësit e shkollës fillore (klasa e parë), shkollës së mesme të ultë (klasa e gjashtë), të mesëm të lartë (klasa e 10), të shkollës profesionale teknike e bujqësore (klasa e 10) dhe koordinatorët e niveleve. Gjithashtu kishte edhe mësimdhënës të përfshirë sipas lëndëve.



Qëllimi i punëtorisë ishte: Të prodhojnë modele të mësimëve paralele për nxënës dhe mësimdhënës në lëndët kyçe duke u bazuar në mësimet e arritura nga punëtorja e parë (19 dhe 20 shkurt 2011).

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Në kuadër të projektit “Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Pas mbajtjes së tri takimeve të komisionit u përcaktuan kriteret ku në bazë të tyre u sjell vendimi për përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara nga ky komision. Si rezultat i kësaj janë përzgjedhur 200 nxënës të shkollave të mesme dhe 20 student. Bursat si për nxënës po ashtu edhe për student do të jepen në baza mujore deri në qershor të vitit të ardhshëm (2012). Nxënësit do të pranojnë bursën në lartësi prej 30 euro ndërsa studentët në lartësi prej 100 euro.

■ Gjatë këtij muaji janë intensifikuar vizitat në qendra, të gjithë qendrat gjatë muajit prill janë vizituar së paku tri herë. Programi për parashkollor, programi për detyra të shtëpisë, aktivitetet rinore janë duke implementuar në bazë të planit të paraparë. Programi i shkrim leximit ju ka kërkuar më shumë kohë qendrave në identifikimin e kandidatëve potencial. Të gjithë qendrat kanë filluar më këtë program përveç qendrës mësimore në Mitrovicë që tani është duke e implementuar këtë program por me një numër më të vogël të pjesëmarrësve sesa është paraparë në planin e këtyre qendrave që janë dorëzuar në KEC.

■ Gjatë muajit prill të gjithë qendrat janë furnizuar me tri pako të ndryshme të materialit didaktik; është bërë furnizimi me kompjuter; janë vendosur masat e sigurisë kundër vjedhjes dhe zjarrit dhe grilat në vendet ku ka qenë e nevojshme; janë furnizuar me tepihë dhe perde. Në bashkëpunim me projektin që implementohet nga Mercy Corps (EU MRSI) në Mitrovicë është ndërmarrë një aksion i përbashkët për meremetimin e shkollës që është lëshuar nga Komuna e Mitrovicës për implementimin e programeve të EU SIMRAES. Meremetimi pritet të përfundohet deri më datën 8 maj 2011.

Përgatiti: Petrit Tahiri